

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:170607

Datë: 15.01.2021

Numri i dokumentit: 01411508

A.nr. 2089/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative me gjyqtaren Arjeta Sadiku, në konfliktin administrativ të paditësve, Pishtarët, organizatë joqeveritare, me adresë në Rr. "Enver Dobraj" Nr. 36, Deçan, përfaqësuar nga Shpresa Loshaj dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike, organizatë jo-qeveritare, me adresë në Rr. "Rexhep Luci Nr.16/1, Prishtinë, përfaqësuar nga Arbëresha Loxha-Stubllla, kundër të paditurave Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës dhe Zyra e Rregullatorit për Energji, në Prishtinë, si dhe pala me interes juridik kompania "Kelkos Energy" – Sh.P.K., përfaqësuar me autorizim nga Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokatë në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimeve dhe me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtit, jashtë seancës, me datën 12 janar 2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë padia e paditësve, "Pishtarët", organizatë joqeveritare, me adresë në Rr. "Enver Dobraj" Nr. 36, Deçan, përfaqësuar nga Shpresa Loshaj dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike, organizatë jo-qeveritare, me adresë në Rr. "Rexhep Luci Nr.16/1, Prishtinë, përfaqësuar nga Arbëresha Loxha-Stubllla, nën shenjën A.nr.2089/20 e datës 4 dhjetor 2020, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispedencës).

A r s y e t i m

Me datën 4 dhjetor 2020, paditësit "Pishtarët" dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike, organizata organizata jo-qeveritare, përmes përfaqësuesve me autorizim, kanë parashtruar padí në këtë gjykatë, kundër të paditurave Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës dhe Zyra e Rregullatorit për Energji, në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar nga gjykata anulimin e vendimeve

Numri i lëndës: 2020:170607
Datë: 15.01.2021
Numri i dokumentit: 01411508

Nr.4982-2/20 të datës 4 nëntor 2020; vendimin Nr.4981-2/20 të datës 3 nëntor 2020; vendimin Nr. 19/5837 të datës 6 nëntor 2020; vendimin Nr 19/5837 të datës 6 nëntor 2002; vendimin Nr.V_1303_2020 të datës 12 nëntor 2020 si dhe vendimin Nr. V_1304_2020 të datës 12 nëntor 2020. Padiësit gjithashtu, me këtë padi kanë kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të lartcekura, deri në vendosjen meritore sipas padisë.

Me datën 12 dhjetor 2020, gjykata u ka dërguar të paditurave aktvendimin për përgjigje në kërkesën e padiësve për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve, ndërsa pas kërkesës së palës me interes juridik për t'u njoftuar me shkresat e lëndës, me datën 30 dhjetor 2020 gjykata i ka dërguar palës me interes juridik aktvendimin për përgjigje në kërkesën e padiësve për shtyrje të ekzekutimit.

Pas pranimit të përgjigjes me shkrim nga palët e paditura si dhe palës me interes juridik, gjykata shqyrtoi lejueshmërinë e padisë dhe pas njoftimit nga ana e shkrimores së kësaj gjykate, vërtetoi se për të njëjtën çështje me aktvendimin A.nr.2081/20 të datës 08.12.2020 gjykata ka vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të njëjta të cilat atakohen me këtë padi dhe çështja vazhdon të procedohet sipas padisë.

Pasi që gjykata e vërtetoi këtë fakt dhe faktit se padia A.nr.2081/20 është proceduar më herët dhe është në procedurë e sipër, konform nenit 262 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), vlerësoi se padia duhet të hedhet poshtë për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispedencës).

Neni 262 i LPK-së përcakton se:

"262.1 Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia.

262.2 Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtarë për kërkesën e tillë.

262.3 Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.

Numri i lëndës: 2020:170607
Datë: 15.01.2021
Numri i dokumentit: 01411508

262.4 Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta”.

Ndërsa neni 63 i LKA-së, përcakton se:

“Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore”.

Pavarësisht faktit se palët paditëse në këtë konflikt administrativ dhe në çështjen tjetër A.nr.2081/20, nuk janë të njëjta siç përcaktohet në mënyrë decitive me nenin 262 të LPK-së, gjykata gjithnjë në bazë të nenit 63 të LKA-së, zbatoi përshtatshmërisht këto dispozita, pasi që vendimet e goditura me padi janë të njëjta dhe kanë karakter të përgjithshëm, si dhe nuk pohojnë apo mohojnë të drejta drejtëpërdrejtë vetëm për paditësit në këtë çështje apo në çështjen tjetër.


Shqyrtimi i çështjes sipas padisë së paditësve në lëndën A.nr.2081/20 ka ndikim të përgjithshëm, rrjedhimisht edhe për paditësit në këtë konflikt administrativ, andaj gjykata vlerësoi se me vendosjen e kësaj çështje si në dispozitiv të këtij aktvendimi, paditësve nuk u mohohet apo cenohet ndonjë e drejtë. Në të kundërtën, vendosja e çështjes në këtë konflikt administrativ për të njëjtat vendime, bie në kundërshtim edhe me parimin universal juridik “ne bis in idem” dhe do të përbënte procedurë duale për të njëjtën çështje.

Andaj, në kuptim të nenit 391 pika c) dhe nenit 262 të LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 2089/20, me datë 12 janar 2020



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.